

Thirrja nga data 25.10.2024 deri në datën 01.11.2024

TERMAT E REFERENCES

PËR

TRAJNER/E PËR OFRIMIN E TRAJNIMIT “PËRDORIMI I MEDIAS SOCIALE NË MËNYRË TË SIGURT DHE EFEKTIV”

| | |
|-------------------|---|
| Organizata | OJQ “NEVO KONCEPTI |
| Objektiva | Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimit në temën “Përdorimi i Medias Sociale në mënyrë të sigurt dhe efektiv” për anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF) në Prizren. |

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

”Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulëta të komunës së Prizrenit.

Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 Asamblesitë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

2. OBJEKTIVA

Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë online, të edukohen fëmijët dhe të rinjtë mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësinë në internet. Zhvillimi i aftësive për menaxhimin e përmbajtjes, të ndihmohen të rinjtë të mësojnë të identifikohen përmbajtjen e besueshme dhe të shmangjin lajmet e rreme apo informacionet e pasakta. Promovimi i ndërveprimit pozitiv online, të cilët mësojnë sjelljet e përshtatshme dhe respektueshme gjatë përdorimit të platformave të medias sociale, për të parandaluar edhe adresuar bullizmin kibernetik.

Nevo Koncepti kërkon një individë (trajnerë) për të ofruar dhe zhvilluar trajnimin një ditorë për fëmijët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve, grup mosha e fëmijëve 12 – 15 vjeçar/e.

3. Kualifikimi i kandidatit/ës

Trajneri/ja duhet të ketë aftësitë dhe njohurinë të nevojshme vijuese:

- Diplomë pasuniversitare (preferohet niveli Master) në shkencat shoqërore të komunikimit ose mediatik;
- 5-7 vjet përvojë pune si trajner/e, duke përfshirë hartimin moduleve të trajnimit dhe ofrimin e programeve
- Shkathtësi të mira komunikimi, organizative, të punës interaktive dhe qasje mësimore adaptive dhe dinamike për të siguruar që të mësuarit përshtatet nevojave të pjesëmarrësve
- Njohuri dhe shkathtësi për të komunikuar dhe punuar me fëmijë dhe të rinj
- Kreativ, i/e hapur, motivues dhe që pranon sugjerimet;
- Respekton afatet kohore
- Të jetë fleksibil për tu përshtatur me orarin e përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF), për të caktuar ditën e trajnimit.
- Të jetë i/e aftë në komunikim me fëmijët, t'i mësoj dhe këshillojë fëmijët mbi temën.
- Të punojë në përputhje me politikatat e Nevo Konceptit sa i përket respektimit të të drejtave të fëmijëve.
- Të ketë ekspertizë mbi temën e lartëcekur (kandidatët preferohet të kenë qertifikime mbi temën)
- Udhëheqë trajnimin me profesionalizëm, sqarojë dhe shtjellojë tematikën dhe termet përkatëse në pajtim me 9 rregullat për pjesëmarrje të sigurt dhe kuptimplotë të fëmijëve:
<https://resourcecentre.savethechildren.net/document/nine-basic-requirements-meaningful-and-ethical-childrens-participation/>

Të punojë në përputhje me politikatat e Nevo Konceptit, sa i përket Politikës për mbrojtjen e fëmijëve mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve.

4. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me 4 Nentor deri me 30 Nentor 2024. Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

| Numri i rezultatit | Tituli i rezultatit | Përshkrimi | Ditët e punës | Data e rezultatit |
|--------------------|--|--|---------------|-------------------|
| 1 | Përgatitja e programit të trajnimit | Zhvillimi / adaptimi i programit të trajnimit, përfshirë materialet e trajnimit, si dhe të formojë vlerësimin Pre Post Test për ‘Përdorimi i Medias Sociale në mënyrë të sigurt dhe efektiv’ | 2 | Nëntor 2024 |
| 2 | Ofrimi i programit të trajnimit për Asamblenë Komunale të Fëmijëve | Ofrimi i trajnimit 1-ditor për një grup të pjesëmarrësve | 1 | Nëntor 2024 |
| 3 | Dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin | Hartimit i raportit përfundimtar mbi angazhimin në trajnimin ‘Përdorimi i Medias Sociale në mënyrë të sigurt dhe efektiv’ | 1 | Nëntor 2024 |
| | Gjithsej: | | 4 | |

5. REZULTATET E PRITSHME

- AKF të jetë e njohur me termet kryesore që ndërlidhen me ‘Përdorimi i Medias Sociale në mënyrë të sigurt dhe efektiv’
- AKF të rritë vetëdijësimin për sigurin online, zhvillimin e aftësive të mendimit kritik, ndërtimin e një imazhi positive online, menaxhimin e kohës, rritja e ndërgjegjësimit për gjuhën dhe sjelljet online.
- AKF të përfitojë njohuri praktike si të jenë qytetarë aktiv, si të ndërmarrin iniciativa sociale dhe si drejtohet institucioneve dhe mekanizmave të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- CV.
- Metodologjia e propozuar e mbajtjes së trajnimit.
- Dy (2) referencë.
- Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.
- Oferten Financiare Bruto

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 01.11.2024** në e.qylangji@nevoconcepti.org duke e kopjuar (cc) në email o.osmani@nevoconcepti.org